

ÇEKLISTA E PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR (PMM)

Për ndërtimin e godinës së shkollës së re 9-vjecare “Bajram Curri” Durrës

HYRJE

Projekti Cilësi dhe Barazi në Arsim (P-CBA) mbështet zbatimin e fazës së parë të Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë për Arsimin (SKE). Objektivi i P-CBA është që të përmirësojë cilësinë e kushteve të të mësuarit për të gjithë studentët, si edhe të rrisë frekuentimin në shkollat e mesme të përgjithshme, vecanërisht të të varfërve. Projekti ka katër prioritete: 1) forcimin e udhëheqjes, menaxhimit dhe qeverisjes së sistemit arsimor, 2) përmirësimin e kushteve të procesit mësimor, 3) përmirësimin dhe racionalizimin e infrastrukturës arsimore dhe 4) përgatitjen e fazës për reformën e arsimit të lartë. Prioriteti i tretë, është përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore, çka përpos rehabilitimit të shkollave ekzistuese, nënkupton zgjerimin apo ndërtimin e tetë shkollave brenda oborreve ekzistuese të shkollave dhe ndërtimin e 12 shkollave të reja në vendndodhje të reja.

KATEGORIA MJEDISORE

Për shkak të veprimtarive që kanë lidhje me ndërtimet dhe që në përgjithësi kanë një impakt të kufizuar, projekti është futur në **Kategorinë B**, në bazë të vlerësimit mjedisor, sipas kritereve të kategorizimeve të Bankës Botërore. Është përgatitur një Manual Operacional i Projektit i cili përshkruan procedurën e kujdesit të posacëm dhe monitorimin e nën-projekteve. Manuali gjithashtu paraqet planin e përgjithshëm të menaxhimit mjedisor. Procedura monitoruese tek Manuali operacional kërkon përgatitjen e dokumentave të vlerësimit mjedisor me synime të ndryshme për çdo lloj nënprojekti, sikurse është paraqitur në tabelën 1. Kjo diktohet nga fakti që investimet e parashikuara nga projekti mund të kenë impakte mjedisore të niveleve të ndryshme. Për ndërtimin e shkollave të reja apo për shtesa në oborrin e shkollave ekzistuese, duhen përgatitur çeklista në PMM-të specifike, në përputhje me udhëzimet e Bankës Botërore si edhe me Manualin Operacional të Projektit të Huamarrësit. Sipas P-CBA, duhet përgatitur çeklista e PMM-ve për ndërtimin e tetë shkollave në oborret e shkollave ekzistuese, sipas P-CBA. Këto janë shkollat nëntëvjeçare në Zallmner, Kamzë dhe Shkolla nëntëvjeçare “Ibrahim Rugova”, Kamzë ; Shkolla e mesme Mallakaster , Ballsh; Shkolla nëntëvjeçare “Besëlidhja”, Lezhë; Shkolla e mesme, Lezhë; shkolla 9-vjecare, Krumë; Shkolla nëntëvjeçare “B.Curri”, Durrës dhe shkolla e mesme “Janaq Kilica”, Fier.

Tabela monitoruese e nënprojektit 1

Lloje të veprimtarive të Kategorisë B	Kërkohet dokumentacion i vlerësimit të mjedisit	E aplikueshme për:
1	Vlerësimi Mjedisor (VM) me Planet e Menaxhimit Mjedisor (PMM) për çdo ndërtim me vete. (nënprojekt)	Shkolla të reja në vende të reja
2	PMM specifike për vendndodhjen për çdo shkollë në formën e nje çekliste.	Shkolla të reja ose shtesa në oborre ekzistues të shkollave.

3	Nuk ka nevojë për PMM specifike për vendndodhjen. Janë të aplikueshme masa të përgjithshme sikurse janë të përshkruara në MOP.	Rehabilitimi i shkollave ekzistuese në oborret ekzistues të shkollave.
---	--	--

Impakte të Mundshme Mjedisore

Impaktet mjedisore të projektit mendohet se mund të jenë të menaxhueshme, të përkohshme dhe të një impakti lokal sepse ato kanë lidhje me veprimtaritë e përgjithshme ndërtuese në vendndodhje të përdorura më parë dhe tashmë të njohura. Këto kanë të bëjnë kryesisht me: a) Pluhurin dhe zhurmën e shkaktuar nga prishjet e ndërtesave dhe mbetjet nga ndërtimet, si edhe derdhje të rastësishme të karburantit të makinave, lubrifikantëve etj. c) Zënie të pronave private; d) Risk nga dëmtimi i pasurive historike dhe kulturore ose vende arkeologjike të pazbuluara; e) shqetësime nga trafiku.

ÇEKLISTA E PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR (PMM)

Çeklista e PMM-ve aplikohet për rehabilitime të vogla ose për ndërtime ndërtesash të një shkalle të vogël, vecanërisht ato në fushën e sektorit arsimor, shëndetësor, dhe ato të rindërtimeve në fushën e shërbimit publik. Kjo ofron një “praktikë të mirë pragmatiste” çka synon të jetë e pranueshme për përdoruesin dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtje dhe siguri të BB.

Çeklista ka katër seksione:

- Prezantimin ose pjesën hyrëse, e cila paraqet projektin, përcakton kategorinë mjedisore dhe sqaron konceptin e çeklistës së PMM.
- **Pjesa 1** paraqet një pjesë përshkruese (“pasaporta e vendndodhjes”) e cila përshkruan specifikat e projektit në lidhje me vendndodhjen fizike, aspektet institucionale dhe legjislative, përshkrimin e projektit, duke përfshirë edhe nevojën e programit të kapacitetit të ndërtimit si edhe përshkrimin e procesit të konsultimit me publikun.
- **Pjesa 2** përfshin një monitorim mjedisor dhe social në një format të thjeshtë Po/Jo që vijon me masat zbutëse për çdo lloj veprimtarie.
- **Pjesa 3** është një plan monitorues për veprimtaritë gjatë ndërtimit dhe implementimit të projektit. Ai duhet të jetë i të njëjtit format sikurse edhe për PMM-të standarde të Bankës Botërore. Kjo çeklistë synon që Pjesa 2 dhe Pjesa 3 të përfshihen si dokumenta tenderimi për kontraktuesit.

Formati i tipit- çeklist, sunon të mbulojë qasjet tipike zbutëse ndaj kontratave të përbashkëta për veprat ndërtuese në lidhje me impaktet e lokalizuara. Çeklista e PMM-ve paraqet impaktet e parashikuara mjedisore dhe ofron praktikën e mirë operacionale për kontrollin e shkarkimeve (p.sh.pluhurin, zhurmën, mbetje gazrash), menaxhim të mbetjeve të ngurta të rrezikshme dhe të parrezikshme në vendin e ndërtimit. Kjo gjithashtu ofron edhe udhëzime për shmangien e përdorimit të substancave të rrezikshme, si bojra toksike, solventë ose solucione pastrimi. Për më tepër Çeklista e PMM-ve do të përfshijë edhe ruajtjen nga trafiku (duke u fokusuar veçanërisht në kujdesin për këmbësorët) në vendet përreth vendit të ndërtimit, në se është e nevojshme. Çeklista e PMM-ve do të

merret gjithashtu edhe me hapat që duhet të ndërmerren në se gjatë zbatimit të veprave ndërtuese mund të gjenden elemente të trashëgimisë kulturore (p.sh. fasada me vlera historike dhe kulturore etj.)

Aplikimi i Çeklistës së PMM-ve

Procesi i projektimit për veprat ndërtuese të parashikuara për Projektin Cilësi dhe Barazi në Arsim, do të ndërmerret në tri faza:

- 1) *Identifikimi i përgjithshëm dhe faza synuese*, gjatë së cilës do të zgjidhen objektet për rehabilitim, zgjerim, dhe/ose ndërtim, si edhe do të përpunohen programe të përafërta për tipologji veprimtarie të mundshme. Pjesa 2 e Çeklistës së PMM-ve mund të përdoret për të zgjedhur veprimtari tipike nga një “menu” duke i lidhur ato me çeshtje tipike mjedisore dhe masa zbutëse.
- 2) *Faza e detajuar dhe faza tenderuese*, duke përfshirë edhe specifikimet dhe faturat e sasive të objekteve të veçanta, duke integruar dispozitat mjedisore në formën tabulare. (shih Pjesa 2 dhe 3). Kjo fazë përfshin gjithashtu edhe kontratat e tenderimeve dhe nënshkrimet e kontratave të punësimit dhe po gjatë kësaj faze, përcaktohen përfundimisht në mënyrë kontraktuale detyrimet e Kontraktorit për të marrë masat mjedisore gjatë punimeve. Para fazës së tenderimit, duhet paraqitur publikisht Çeklista e PMM-ve.
- 3) *Gjatë fazës së zbatimit të punimeve*, inspektori (inspektorët) e certifikuar të vendit të punimeve, kontrollojnë përmbushjen e detyrimeve mjedisore në vendin e punimeve, së bashku me kritere të tjera cilësore. Masat zbutëse në Pjesën 2 dhe plani monitorues në Pjesën 3 përbëjnë bazën për verifikimin e përmbushjes nga ana e kontraktorit të dispozitave të kërkuara mjedisore.

Aplikimi praktik i Çeklistës së PMM, do të përfshijë plotësimin e Pjesës 1 për të patur dhe për të dokumentuar të gjitha karakteristikat përkatëse të vendit. Në pjesën 2, veprimtaritë që do të zbatohen, do të kontrollohen sipas llojit të veprimtarive të parashikuara dhe në pjesën 3 do të identifikohen parametrat monitorues sipas veprimtarive të paraqitura në Pjesën 2.

Gjithë tabela e plotësuar e PMM (Pjesa 1, 2 dhe 3) duhet bashkëngjitur si shtesë e pjesës integrale për punët e kontratës si edhe analoge me të gjitha kushtet teknike dhe tregtare e cila duhet firmosur nga palët kontraktuese.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Për monitorimin e masave të kujdesit të posacëm të Kontraktuesit, i ngarkuari me detyrën e inspektorit të ndërtimit dhe inxhinieri i mbikëqyrjes së vendit duhet të punojnë me **Pjesën 3** të Çeklistës së PMM të planit monitorues. Kjo duhet përgatitur në përputhje me specifikat e vendit dhe me hollësitë e dhura, duke përcaktuar kritere të qarta dhe parametra të cilat duhen përfshirë në kontratat e punës, dhe të cilat duhet të pasqyrojnë statusin e praktikës mjedisore në vendin e ndërtimit dhe të cilat mund të vëzhgohen, maten, kuantifikohen dhe verifikohen nga inspektori gjatë veprave të ndërtimit.

Pjesa 3 kësajsoj do të përditësohet dhe rishikohet gjatë procesit të projektimit për të rregulluar kritere thelbësore monitoruese të cilat mund të kontrollohen gjatë

dhe para veprave në se ka përputhje me sigurinë dhe përfundimisht me pagesën e Kontraktuesit.

Këto parametra përfshijnë përdorimin e Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM) nga punëtorët në vendin e punës, sasinë e prodhimit të pluhurit dhe mbrojtjen nga ai, sasinë e ujit të përdorur dhe të shkarkuar në vendin e ndërtimit, prezencën e objekteve të nevojshme sanitare për punëtorët në vendin e ndërtimit, grumbullimin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (mbetje minerale, druri, metali, plastike, mbetje të rrezikshme, p.sh.azbest, mbetje bojrash, mbetje të vajrave të motorëve), sasi mbetjesh, organizim të duhur të rrugëve dhe mjedisëve të shkarkimit të mbetjeve ose ripërdorimin e tyre dhe riciklimin e tyre sa herë që lind nevoja. Vec Pjesës 3, inxhinieri i vendit duhet të kontrollojë në se kontraktuesi respekton masat zbutëse të Pjesës 2.

Raporti i monitorimit i Inspektorit të vendit apo i inxhinierit të vendit, duhet të jetë një parakusht për pagesën e plotë të shpërblimit sipas kontratës, po ashtu edhe kriteret e cilësisë teknike ose vrojtme mbi cilësinë. Me qëllim që të sigurohet një shkallë rritjeje në performancën mjedisore te Kontraktuesit, duhet futur edhe nje klauzolë në kontratat e punës e cila të specifikojë dënimet në rast të mosrespektimit të dispozitave kontraktuale p.sh. në formën e mbajtjes së një pjese të pagesave, sasia e së cilës varet nga fakti se sa e rëndë do të jetë shkelja e kontratës. Për raste ekstreme, duhet parashikuar edhe prishja e kontratës.

SHTOJCA: Çeklista e PMM-ve për Veprimtaritë Ndërtuese dhe Rehabilituese

PJESA 1: INSTITUCIONALE & ADMINISTRATIVE				
Vendi	Shqipëria			
Titulli i Projektit	Projekti Cilësi dhe Barazi në Arsim			
Qëllimi i Projektit dhe i Veprimtarisë	Arsimi			
Rregullime Institucionale (Emri dhe Kontaktet)	BB TTL Andrea C. Guedes	Menaxhimi i Projektit Ministria e Arsimit dhe Shkencës Sekretari-e Përgjithshëm në MASH Drejtorë të drejtorive përkatëse në MASH Person i caktuar për koordinimin dhe mbikëqyrjen e planeve mjedisore (Sokol Milo)	Pala Vendore dhe/ose Marrësi Bashkia Durres (Ani Sako)	
Rregullime zbatimi (Emri dhe kontaktet)	BB Mbikëqyrja për Sigurinë Natasha Vetma	Pala Vendase për Mbikëqyrjen: Bashkia Durres (Ina Xhako) Inxhinieri Mbikëqyrës (emri do te vendoset pas nenshkrimit te kontrates)	Mbikëqyrja nga Inspektoriati Vendor Konsulentët (Veiz Lluka) (Eugen Minga)	Kontaktuesi (emri do te vendoset pas nenshkrimit te kontrates)

Përshkrimi i Vendit				
Emri i Vendit	Shkolla 9-vjecare ne oborin e shkolles B.Curri Durrës			
Përshkruani vendndodhjen	Shkolla e re do të ndërtohet tek oborri ekzistues i shkollës së 9-vjecare “Bajram Curri” Durrës. Sipërfaqja e ndërtimit është 1,818 m ² , kurse sipërfaqja totale e truallit është 4,477 m ² . Kompleksi aktual i shkolles perbehet nga 4 godina te ndryshme, 2 nga te cilat jane jashte perdorimit dhe do te shemben kurse 2 godinat qe mbeten do te qendrojne dhe do te perdorin te njejtin oborr me shkollen e re qe do te ndertohtet. Shkolla e re eshte konceptuar si nje kombinim i 3 blloqeve me 3, 2 dhe 1 (palestra) kate me nje salle ne katin e 4 ^{rt} me nje siperfaqe te pergjithshme ndertimi prej 5.053 m ² . 50% e siperfaqes se oborrit parashikohet te jete siperfaqe e gjelbert dhe nje pjese tjeter parashikohet per terrene sportive.	Shtesa 1: Informacion për vendin (figura nga vendi) [x]Y [] N		
Kush është pronari i tokës?	Toka është pronë publike			
Përshkrimi gjeografik	Durrësi është një qytet që ndodhet në Shqipërinë e mesme me një popullsi prej mbi 160,000 banorë sipas llogaritjeve të vitit 2007. Bashkia e Durrësit është bashkita e dyte më të madhe në Shqipëri. Ai shtrihet në kufi me rrethet e Tiranës dhe Kavajës. Durrësi ndodhet në Detin Adriatik. Zona ku ndërtohet shkolla është zonë pranë plazhit të Durrësit ku kemi në vitet e fundit një rritje të fluksit të popullsisë në mënyrë të dukshme.			
LEGJISLACIONI				
Identifikoni legjislacionin kombëtar dhe vendor, si edhe lejët që kanë lidhje me veprimtaritë e projektit.	Ligjet e mëposhtme shqiptare përcaktojnë një kuadër ligjor për menaxhimin e mjedisit: Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit, No. 8934 data 5 shtator 2002 si edhe Ligji mbi Vlerësimin e Impaktit Mjedisor, No. 8990, data 23 janar, 2003. Sipas ligjit mbi Vlerësimin e Impaktit Mjedisor VIM, kjo nuk kërkohet për ndërtimin e shkollave. Lejët e ndërtimit që kërkohen, lipset të identifikojnë disa masa thelbësore mjedisore që kanë lidhje me mbetjet, masat mbrojtëse dhe trafikun.			
KONSULTIMI PUBLIK				
Identifikoni se kur dhe ku ka ndodhur konsultimi me publikun	Në pritje			
NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE				
A do të ketë ndonjë ngritje kapaciteti?	[] PO ose [x] JO , në se Po, informacioni për ngritjen e kapaciteteve gjendet tek Shtesa 2.			

PJESA 2: MONITORIMI MJEDISOR /SOCIAL			
A do të përfshijë/përmbajë veprimtaria tek vendi i ndërtimit, ndonjë nga pikat e mëposhtme:	Veprimtaria	Statusi	Referenca shitesë
	A. Rehabilitimi i ndërtesës	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin B më poshtë
	B. Ndërtim i ri	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin B më poshtë
	C. Sistem i vecantë i trajtimit të ujrave të zeza	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin C më poshtë
	D. Ndërtesë(a) dhe rrethe historike	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Possible	Shih seksionin D më poshtë
	E. Marrje e tokës ¹	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin E më poshtë
	F. Materiale të rrezikshme ose toksike ²	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin F më poshtë
	G. Impaktet mbi pyjet dhe/ose zonat e mbrojtura	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin G më poshtë
	H. Trajtimi / menaxhimi i mbetjeve mjekësore	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Shih seksionin H më poshtë
	I. Kujdesi ndaj trafikut dhe mbrojtja e kalimtarëve	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> No	Shih seksionin I më poshtë

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
A. Kushtet e Përgjithshme	Njoftime dhe Masa mbrojtëse për Punëtorët	<ul style="list-style-type: none"> (a) Inspektoriatet vendore të ndërtimit dhe të mjedisit janë njoftuar për veprimtaritë e ardhshme (b) Publiku është njoftuar për veprat ndërtuese nëpërmjet publikimeve në media dhe/ose nëpërmjet qendrave të disponueshme publike duke përfshirë edhe vendin e ndërtimit. (c) Janë marë të gjitha lejet e kërkuara ligjërish për ndërtim dhe/ose rehabilitim. (d) Gjithë veprimtaria do të kryhet në një mënyrë të kujdesshme dhe të disiplinuar duke synuar minimizimin e impaktit tek banorët përreth dhe tek mjedisi. (e) PPE të punëtorëve do të respektojnë praktikatat e mira ndërkombëtare (duke mbajtur gjithmonë kapele mbrojtëse, maska sipas nevojës dhe syze mbrojtëse, litarë dhe çizme sigurie.) (f) Tabela njoftimesh në vendet e ndërtimit do t'i njoftojnë punëtorët për rregullat thelbësore si edhe rregulloret që duhen zbatuar.
B. Rehabilitim i Përgjithshëm dhe /ose Veprimtari Ndërtimi	Cilësia e Ajrit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Gjatë prishjeve të brendshme përdorni mbrojtëse nga mbeturinat e prishjeve të ndërtesës mbi katin e parë. (b) Mbani mbeturinat nga prishja e ndërtesës në vende të kontrolluara dhe spërkatini ato me ujë me qëllim që të ulet niveli i pluhurit nga mbeturinat e prishjeve. (c) Mos lejoni shpërndarjen e pluhurit gjatë gërmimeve pneumatike/shkatërrimeve të mureve, duke spërkatur vazhdimisht me ujë ose duke instaluar mbrojtëse nga pluhuri në vendin e ndërtimit. (d) Pastroni mjedisin rrethues (trotualet, rrugët), nga mbetjet me qëllim që të minimizoni

¹Marrja e tokave ka të bëjë me zhvendosjen e njerëzve, ndryshimin e kufijve të tokave dhe të pronave private në tokat e blera/ të transferuara që prek njerëzit që jetojnë atje dhe/ose të zaptuesve dhe/ose që merren me një biznes(kioska) në tokën e marë.

² Maeriali toksik / I rrezikshëm përfshin dhe nuk kufizohet tek azbesti, bojrat toksike, largimi I bojrave të plumbit, etj.

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
		<p>pluhurin.</p> <p>(e) Nuk lejohet që të bëhen djegje materialesh apo mbetjesh në vendin e ndërtimit.</p> <p>(f) Duhet mbajtur nën kontroll lëvizja e tepruar e makinave të ndërtimit në vendin e ndërtimit.</p>
	Zhurma	<p>(a) Zhurma e ndërtimeve duhet kufizuar në orët e kufizuara për këtë punë sipas lejës.</p> <p>(b) Gjatë funksionimit të tyre, kapakët e gjeneratorëve, kompresorët e ajrit dhe pajisje të tjera mekanike duhet të jenë të mbyllura dhe pajisjet duhen vendosur sa më larg zonave të banuara që të jetë e mundur.</p>
	Cilësia e Ujit	<p>(a) Vendi i ndërtimit duhet të marë masat e duhura kundër erozionit dhe sedimentit, si p.sh. ngritjen e pengesave dhe ta gardheve për të penguar daljen e sedimentit nga vendi i ndërtimit duke shkaktuar kështu turbullira në lumenjtë dhe përrenjtë perreth.</p>
	Menaxhimi i Mbetjeve	<p>(a) Grumbullimi i mbetjeve dhe vendshkarkimet e tyre do të identifikohen për të gjitha llojet e mbetjeve që do të krijohen nga prishjet dhe nga veprimtaritë ndertuese.</p> <p>(b) Mbetjet nga ndërtimet minerale dhe nga prishjet e ndërtesave, duhet të ndahen nga mbetjet e përgjithshme organike, të lëngjeve, dhe kimike, duke bërë seleksionimin e tyre në vend dhe duke i vendosur në kontenerë të përshtatshëm.</p> <p>(c) Mbetjet nga ndërtimet do të grumbullohen dhe do të shkarkohen në mënyrën e duhur nga kolektorë të licencuar.</p> <p>(d) Do të ruhet dokumentacioni për shakrkimin e plehrave si provë për menaxhimin e mbetjeve sipas kërkesave..</p> <p>(e) Sa herë që kjo do të jetë e mundur, kontraktori do të ripeërdorë dhe do të riciklojë materialet e duhura dhe të përdorshme me perjashtim të azbestit.</p>
C. Sistemi i trajtimit të vecantë ujrave të zeza	Cilësia e Ujit	<p>(a) Qasja për trajtimin e mbetjeve sanitare dhe të ujrave të zeza nga vendet e ndërtimit (instalimi ose rindërtimi) duhet miratuar nga autoritetet vendase.</p> <p>(b) Para se të shkarkohet në ujrat pritëse, duhen trajtuar mbetjet nga sistemet e ujrave të zeza me qëllim që të përmbushin kriteret minimale të cilësisë sipas përcaktimeve të udhëzimeve kombëtare mbi cilësinë e mbetjeve ujore dhe trajtimin e ujrave të zeza.</p> <p>(c) Do të kryhet monitorimi i sistemeve të reja të ujrave të zeza (para/pas)</p>
D. Ndërtesë (a) historike(s)	Trashëgimia kulturore	<p>(a) Në se ndërtesa është një strukturë me rëndësi historike apo shumë pranë një strukture të tillë, apo që ndodhet në një zonë të përcaktuar me rëndësi historike, duhen njoftuar dhe duhen marrë lejë miratimi nga autoritetet vendore dhe duhen kryer gjithë veprimtaritë ndërtuese sipas legjislacionit kombëtar.</p> <p>(b) Sigurohuni që të respektohen gjithë dispozitat me qëllim që veprat e artit apo “zbulime të rasti” që bëhen gjatë gërmimeve ose gjatë ndërtimeve, të mbahen shënim, të kontaktohen zyrtarët dhe të pezullohen punërat ndërtimore apo të modifikohen ato duke u marrë parasysh zbulime të tilla.</p>
E. Marrja e	Kuadri/Plani i Marrjes së	<p>(a) Në se shpronësimi i tokës nuk ishte i parashikuar por nevojitet të bëhet, ose në se nuk</p>

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
tokës	tokës	<p>pritej por mund të ndodhë humbja e aksesit ndaj të ardhurave i përdoruesve të ligjshëm apo të paligjshëm, atëhere duhet konsultuar me Udhëheqësin e Ekipit të Projektit, nga Banka.</p> <p>(b) Do të zbatohet Plani/Kuadri i miratuar i Marrjes së tokës.</p>
F. Materiale Toksike	Menaxhimi i Azbestit	<p>(a) Në se azbesti ndodhet në vendin e projektit, duhet paraqitur qartë si material i rrezikshëm.</p> <p>(b) Kur të jetë e mundur, azbesti duhet mbyllur si duhet dhe duhet vulosur me qëllim që të minimizohet ekspozimi i tij.</p> <p>(c) Para se të hiqet, (në se kjo është e nevojshme), azbesti duhet trajtuhet me një lëndë lagëse me qëllim që të minimizohet pluhuri i tij.</p> <p>(d) Azbesti duhet trajtuar dhe të shkarkohet nga profesionistë të aftë/me përvojë.</p> <p>(e) Në se materiali i azbestit, depozitohet perkohësisht, mbetjet duhen mbyllur brenda objekteve të mbyllura të etiketuara si duhet.</p> <p>(f) Azbesti që është hequr nga vendi, nuk do të përdoret.</p>
	Menaxhimi i Mbetjeve Toksike / të rrezikshme	<p>(a) Depozitimi i përkoshëm i të gjitha substancave të rrezikshme në vendin e ndërtimit, duhet bërë në kontenierë të sigurt me etiketa që të tregojnë detaje të përbërjes, komponentëve dhe trajtimit.</p> <p>(b) Kontenierët e substancave të rrezikshme duhen vendosur në kontenierë me mbrojtje nga rrjedhja me qëllim që të mos lejohet derdhja dhe rrjedhja.</p> <p>(c) Mbetjet transportohen nga mjete të licencuara posacërisht dhe shkarkohen në një vend të licencuar.</p> <p>(d) Nuk duhet të përdoren bojra me përbërës apo solventë të rrezikshëm, ose me bazë plumbi.</p>
G. Dëmton pyjet dhe /ose zonat e mbrojtura	Mbrojtja	<p>(a) Të gjitha mjediset natyrore dhe zonat e mbrojtura përreth vendit, nuk do të dëmtohen apo të shfrytëzohen, për gjithë stafin do të ndalohet rreptësisht që të gjuajë, të kullojë bagëtinë, të presë dru apo të kryejë veprimtari të tjera dëmtuese.</p> <p>(b) Kur ndesheni me pemë të mëdha në afërsi të vendit të akivititetit, shënoni vendin dhe rrethojeni me kordon të madh, ruani sistemin e rrënjëve dhe shmangni cdo dëm që mund t'ju bëhet pemëve.</p> <p>(c) Duhet mbrojtur ligatinat dhe përrenjtë në afërsi të vendit të ndërtimit, nga rrëshkitjet e ndërtimeve, duke ngritur objekte që mbajnë nën kontroll erozionin dhe sedimentin, duke përfshirë por jo duke u kufizuar tek gardhet për depozitat dhe mullarët e barit.</p> <p>(d) Nuk do të lejohen gropa guroresh të palicencuara apo hedhje të mbetjeve në zonat e afërta, vecanërisht në zona që janë të mbrojtura.</p>
H. Shkarkimi i mbetjeve mjekësore.	Infrastructura për menaxhimin e mbetjeve mjekësore	<p>(a) Në përputhje me rregulloret kombëtare, kontraktuesi do të sigurohet që objektet e porsandërtuara dhe/ose të rehabilituara të qendrave shëndetësore të kenë infrastrukturë të mjaftueshme për trajtimin e mbetjeve mjekësore dhe shkarkimin e tyre. Kjo përfshin por nuk është e kufizuar tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Godina të vecanta për mbetjet e vecanta të kujdesit shëndetësor (duke përfshirë instrumenta të ndotura “pinceta”, dhe mbetje njerëzore ose lëngje) nga shkarkime të

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
		<p>tjera mbetjesh; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedise të përshtatshme shkarkimi të mbetjeve mjekësore dhe ▪ Në se veprimtaria përfshin trajtim në mjedis, të sigurohet që të ketë opsione të përshtatshme dhe operacionale për shkarkimin e tyre.
<p>I Kontrolli i trafikut dhe Mbrojtja e Këmbësorëve</p>	<p>Rreziqet e drejtpërdrejta ose indirekte për tradikun e publikut dhe të këmbësorëve nga veprimtaritë e ndërtimit.</p>	<p>(a) Në përputhje me rregulloret kombëtare, kontraktuesi duhet të sigurohet që vendi i ndërtimit të jetë i mbrojtur mirë dhe trafiku që ka lidhje me ndërtimin të jetë i kontrolluar mirë. Kjo përfshin por nuk është e kufizuar tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendosja e shenjave dhe tabelave të qarkullimit, shenja paralajmëruese, pengesa dhe shmangje të trafikut. Vendi i ndërtimit duhet të jetë qartësisht i dukshëm dhe publiku duhet të njoftohet për gjithë rreziqet e mundshme. ▪ Sistemi i menaxhimit të trafikut dhe trajnimi i stafit, vecanërisht për aksesin tek vendi i ndërtimit, dhe trafikun e ngarkuar pranë vendit të ndërtimit. Ofrimi i kalimeve të sigurta dhe rrugëve për këmbësorët aty ku ka ndërhyrje të trafikut për ndërtimet. ▪ Përshtatja e orëve të punës me modelet e trafikut lokal, p.sh. shmangja e veprimtarive të mëdha të transportit gjatë orëve të pikut të trafikut ose gjatë orëve të lëvizjeve të bagëtive. ▪ Menaxhim aktiv i trafikut nga staf i trajnuar dhe i dukshëm në vendin e punimeve, në se kërkohet për kalimin e sigurt dhe të përshtatshëm të publikut. ▪ Sigurimi i aksesit të vazhdueshëm dhe të sigurt për tek objektet e zyrës, dyqanet, dhe rezidenat gjatë veprimtarive rinovuese, në se ndërtesat rrinë hapur për publikun.

PJESA 3 : PLANI MONITORIMIT

FAZA	CILI (A do të monitorohet parametri?)	KU (A do të monitorohet parametri ?)	SI (A do të monitorohet parametri ?)	KUR (Përcaktoni frekuencën / ose vazhdimësinë?)	PSE (A po monitorohet parametri?)	KOSTUA (në se nuk është e përfshirë në buxhetin e projektit)	KUSH (është përgjegjës për monitorimin?)
Gjatë përgatitjes së veprimtarisë	Lejët	Në vend	Duke kontrolluar në se i kanë të gjitha lejët e kërkuara nga ligji, në vendin e ndërtimit.	Para se të fillojnë veprat e ndërtimit	Rekomandohet që të sigurohet në se po aplikohen të gjitha praktikatat e mira	Duhet të jetë pjesë e buxhetit të projektit	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit
	Organizimi i vendit	Në vend	Duke kontrolluar në se është bërë rrethimi i duhurr, instalimi i mjeteve të përkohshme sanitare.	Para se të fillojnë veprat e ndërtimit		Kontraktori është përgjegjës për koston totale, zakonisht kjo nuk identifikohet si kategori vecmas	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit
Gjatë zbatimit të veprimtarisë	Cilësia e ajrit (pluhuri)	Në vend	Vëzhgim Pamor	Në vazhdim por gjithsesi duhet kushtuar vëmendje e	Mbajtja e nivelit të pluhurit në minimum me qëllim që të	Kontraktori është përgjegjës për koston totale,	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit , Bashkia

				gërmimit	syve.	vecmas	
	Zhurma	Në vend dhe përreth	Zbulues i nivelit të tingujve	Në javën e parë të ndërtimit dhe pas cdo ankese nga popullata vendase.	Të sigurohet që niveli i zhurmës është në nivel të pranueshëm ligjërisht	800 Euro / Kostua përballohet nga Kontraktuesi i Matjeve	Kontraktuesi, Inxhinieri mbikëqyrës i vendit
	Mbetjet (jo të rrezikshme dhe të rrezikshme të cilat mund të përfshijnë bojra, kimikate, patinime apo materiale ndërtimi që përmbajnë sa më sipër.)	Në vend	Dokumentacion i cili shoqëron mbetjet i cili i paraqitet Ministrisë së Mjedisit për llojin dhe sasinë e mbetjeve të identifikuar.	Në vazhdimësi, d.m.th. sa herë që hiqen mbetjet na vendi.	Kërkohet nga një sërë rregulloresh mbi mbetjet.	Pjesë e praktikës së rregullt të kontraktuesit, mbulohet tërësisht nga kontraktuesi	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit Bashkia, Ministria e Mjedisit (inspektimi)
	Objekte Arkitekturore	Në vend	Mbikëqyrje e plotë nga inspektori i vendit gjatë gërmimeve.	Gjatë gërmimeve për themelet	Të pengojë degradimin e objekteve të rëndësishme arkeologjike që mund të zbulohen.	Pjesë e inxhinierit mbikëqyrës dhe kostos së kontraktuesit.	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit . Bashkia, inspektimi
	Material toksik/i rrezikshëm	Në vend	Trajtimi i duhur dhe depozitimi kontrollohet sipas materialeve ISDS.	Në vazhdimësi	Të mos lejojë derdhjet aksidentale ose plagosjet	Pjesë e kostos së rregullt të kontraktuesit	Kostot për Inxhinierin mbikëqyrës, inspektimi
	Hazard to public traffic and pedestrian safety	On site and on roads permitted to use for accessing site	Vëzhgim Pamor dhe ankesa të mundshme nga publiku	kontroll i përditshëm i shenjave, gardheve dhe shenjave	Të ndalojë rregullimet në trafik dhe aksidentet	Pjesë e kostos së rregullt të kontraktuesit	Kostot për Inxhinierin Mbikëqyrës, inspektimi

				modeleve sinjalizuese të trafikut.			
	Masat mbrojtëse për punëtorët	Në vend	Vëzhgim Pamor	Të kontrollojë në vazhdimësi për përdorimin e pajisjeve të duhura.	Të mos lejojë aksidentet	Pjesë e kostos së rregullt të kontraktuesit	Kostot për Inxhinierin Mbikëqyrës , inspektimi
Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë	Menaxhimi i mbetjeve (mbetjet bashkiake dhe kimikate të laboratorëve)	Mbetjet që shoqërojnë dokumentacionin që i paraqitet Ministrisë së Mjedisit	Pas raportimit mbi menaxhimin e mbetjeve në Ministrinë e Mjedisit	Në vazhdimësi gjatë veprimtarive	Kërkohet nga një sërë rregulloresh mbi mbetjet	Pjesë e kostos së rregullt të veprimtarive	Ministria e Mjedisit (inspektimi)

Shtojca 1 Vendi dhe specifikimet e ndërtesës së re

Figura 1 dhe 2 paraqesin shkollën si edhe oborrin ku do të ndërtohet shkolla e re 9 vjecare ne oborin e shkolles “Bajram Curri” Durres



Figura 1 Oborri i shkollës Bajram Curri Durres



Figura 2 Sheshi i ndertimit per shkollen 9 vjecare ne oborin e shkolles B.Curri Durres

Projekti i shkollës së re do të bazohet tek Plani i Përgjithshëm i përgatitur nga Autoritetet Vendore. Shkolla do të ketë orientim jugperendim dhe veriperendim me qëllim që klasat të kenë ndricim natyror dhe të jenë të ngrohta. Kjo ndërtesë do të jetë e përbërë nga tre blloqe që do të jenë vetë shkolla (dy blloqe) dhe palestra. Tabela e mëposhtme paraqet mjediset e planifikuara brenda ndërtesës. Janë përgatitur udhëzimet e përgjithshme të projektit që kanë lidhje me madhësinë e llojeve të ndryshme të objekteve në shkollë, me komunikimin midis këtyre objekteve, me kalime emergjence për personat me aftësi të kufizuar, me objekte elektrike dhe me ndricim, me kerkesa per masat mbrojtese, me telefon dhe internet, me insulim termal, dhe me ngrohje për panoramën e jashtme.

Tabela 2 Mjediset e planifikuara brenda ndërtesës së re shkollore

Zona	Përshkrimi	Numuri i dhomave	Numuri nxënësve	Sipërfaqja në m ² per cdo nxënës	Sipërfaqja Totale e dhomës	Sipërfaqja Totale e gjithë dhomave
Sipëfaqet e Procesit Mësimor						
	Klasa të përgjithshme	26	30		50	1,300
	Laboratori i Fizikës + aneksi	1	30		75	75
	Laboratori i Kimisë + aeksi	1	30		75	75
	Laboratori i Biologjisë + aneksi	1	30		70	70
	Laboratori	1	30		57	57

	Kompjuterit					
	Zona shumë-funktionale	1	180		185	185
	Dhoma Audio-vizuale	-	30		-	-
	Biblioteka	1	30		75	75
BLLOKU I DREJTUESVE TË SHKOLLËS						
	Drejtoria	1			27	27
	Sekretariati	1			27	27
	Zv.Drejtoria	1			25	25
	Salla e mbledhjeve	-			-	-
	Salla e mësuesve (dhoma e operacioneve)	1	43		95	95
	Dhoma e Mësuesve (dhoma e studimit)	1			85	85
	Arkiva	1			20	20
	Dentisti	1			21	21
	Doktori	1			27	27
	Asistenca Sociale	1			23	23
	Dhoma e rojeve	1			10	10
Anekset						
	Fast Food	1			60	60
	Shërbimi + Guzhina	1			10	10
	Palestra dhe anekset e saj.	1			490	490
	Depua e shkollës	1			11	11
	Banjat për nxënësit	-			140	140
	Banjat për mësuesit dhe njerëzit me aftësi të kufizuar	3			10	30
Zonat e shërbimit						
	Depozitat e Gazit	-			-	-
	Dhoma e Kaldajës	1			53	53
	TOTALI SHKOLLA + PALESTRA M ²					5,053

Shtojca 2 Kapacitet për monitorimin e respektimit të politikave mjedisore.

Sekretari i Përgjithshëm i MASH do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve në nivel teknik, duke përfshirë planifikimin dhe menaxhimin e mjedisit. Drejtorët e departamenteve përkatëse të MASH, Departamenti i Programeve të Zhvillimit dhe kryetarët e instituteve do të jenë përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve. MASH do të jetë përgjegjës për të punësuar dhe të mbikëqyrur konsulentin mjedisor, arkitektët, inxhinierët dhe kontraktorët. Në kontekstin e rehabilitimit, zgjerimit dhe ndërtimit të shkollave, roli i MASH është të menaxhojë projektimin, ofertimin dhe mbikëqyrjen e projekteve (duke përfshirë punimet e ndërtimit, mallrat dhe shërbimet). Përgjegjësia e MASH përfshin veprimtaritë e mëposhtme në lidhje me masat mbrojtëse mjedisore:

Përgjegjësia e MASH përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- Marrja në punë e konsulentit mjedisor i cili do të përgatisë dokumentet për due diligence mjedisore për vendndodhjet individuale në bashkërendim me MASH dhe bashkitë/komunat dhe gjatë fazës së zbatimit të projektit do të mbikëqyrë zbatimin e PMM-ve dhe do të raportojë për to (bashkia/komuna do të punësojë inxhinierin e saj për mbikëqyrjen e sheshit i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së ndërtimit);
- Sigurimi që aspektet përkatëse të PMM janë detyrime kontraktuale për kontraktuesin;
- Mbikëqyrja e punës së kryer nga konsulenti mjedisor, kompanitë inxhinierike / projektuese për të siguruar që ata po zbatojnë standarte të përshtatshme dhe po ndjekin procedurat e rëna dakord, si dhe planin mjedisor të miratuar.
- Organizimi i procedurave të tenderimit, shqyrtimi i vlerësimit të tenderit të kryer nga firmat artikeurore/inxhinierike, dhe organizimi që kontratat të nënshkruhen në përputhje me procedurat e rëna dakord.
- Sigurimi që konsulenti mjedisor po kryen një mbikëqyrje të duhur të sheshit, veçanërisht mbikëqyrjen e realizimit të planit të menaxhimit mjedisor.
- Caktimi i një ekipi për çështjet e ndërtimit dhe mjedisore në Departamentin e Programeve të Zhvillimit pranë MASH.

Ministria nuk ka një njësi të veçanta mjedisore. Për arsye se zbatimi i EEE-P do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis përmes rehabilitimit, zgjerimit dhe ndërtimit të shkollave, një ekip në Departamentin e Programeve të Zhvillimit do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e planeve mjedisore dhe masat për zbutjen e rrezikut të ndërmarrja në Projekt dhe të bashkëpunojnë me departamentet territoriale për mbrojtjen e mjedisit. Për të kompensuar mungesën e kapaciteteve brenda ministrisë, një konsulent mjedisor do të punësohet nga Ministria i cili do t'i raportojë drejtpërdrejt ekipit në Departamentin E Programeve Zhvillimit, dhe Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri për zbatimin e PMM-ve. Konsulenti do të jetë përgjegjës për përgatitjen e PMM-ve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Do të ofrohet trajnim për personelin. Në raportin e parë mbi progresin e zbatimit të projektit një grup në Departamentin e Programeve të Zhvillimit do të propozojë një program trajnimi. Ekipi do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Programeve të Zhvillimit dhe Sektorin Juridike që do të jetë përgjegjëse për prokurimet dhe aspektet ligjore të projektit dhe Sekretari i Përgjithshëm përgjegjës për koordinimin e programit. Ekipi, me mbështetjen e konsulentit të mjedisit:

- do të koordinojë trajnimin mjedisor për personelin, projektuesit dhe kontraktorët lokalë;
- do të shpërndajë udhëzimet ekzistuese të menaxhimit mjedisor dhe do të hartojë udhëzime në lidhje me çështjet që nuk mbulojnë nga legjislacioni ekzistues për zbatimin dhe vlerësimin e masave të lehtësimit;
- do të sigurojë kontraktimin për ndërtimin dhe furnizimin e pajisjeve përfshirë referimin tek udhëzimet dhe standartet e përshtatshme;
- do të koordinojë / kryejë shqyrtimin mjedisor të nën-projekteve;
- do të kryejë vizita periodike në terren për të inspektuar dhe miratuar planet dhe për të monitoruar përputhshmërinë; dhe
- do të përgatisë raportet e tij dhe të konsolidojë raportet nga bashkitë/komunat dhe inxhinierët e mbikëqyrjes së sheshit mbi zbatimin e PMM-ve.

Bashkitë/komunat do të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërtimit për të siguruar, ndërmjet të tjerave, përputhje të plotë me udhëzimet mjedisore të përfshira në këtë MOP dhe PMM-të individuale.

Bashkitë/komunat ku do të ndërtohen shkollat e reja në oborret ekzistuese apo në vendndodhjet e reja do të jenë përgjegjëse për prokurimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë punëve përkatëse. Bashkitë/komunat do të jenë përgjegjëse për:

- prokurimin e punimeve që lidhen me ndërtimin e shkollave të reja të financuara në kuadër të EEE-P si dhe inxhinierin e mbikëqyrjes së sheshit;
- sigurimin që masat dhe monitorimi në Vlerësimet Mjedisore/PMM-të individuale të bëhen pjesë e marrëveshjes me kontraktin dhe inxhinierin e mbikëqyrjes së sheshit; dhe
- mbikëqyrja e ndërtimit për të siguruar, ndërmjet të tjerave, përputhshmëri të plotë me udhëzimet mjedisore që janë në këtë MOP dhe PMM-të individuale.

Pas përfundimit të ndërtimit, përgjegjësia kryesore e monitorimit do të bjerë mbi personelin e Shkollës, veçanërisht mësuesit e laboratorëve shkencore, të cilët do të jenë përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve që vijnë nga laboratorët dhe personeli i mirëmbajtjes së shkollës përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve komunale.

SHKURTIME DHE AKRONIME TE PERDORURA:

PMM	Plani Menaxhimit Mjedisor
P-CBA	Projekti Cilesi dhe Barazi ne Arsim
SKA	Strategjia Kombëtare Arsimit
VM	Vleresimi Mjedisor
MOP	Manuali Operacional i Projektit
BB	Banka Boterore
VIM	Vleresimi i Impaktit Mjedisor